

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SH.A

VENDIM TEKNIK Nr. 2-T

“Aftësitë Profesionale të Agjentëve Tregtar të Certifikuar pjesëmarrës në Tregjet e ALPEX-it”

Në mbështetje të dispozitave të përcaktuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe përkatësisht në seksionin F.4.3, siç janë në fuqi:

ALPEX sh.a miratoi:

1. Vendimin Teknik - Aftësitë profesionale të Agjentëve Tregtar të Certifikuar pjesëmarrës në Tregjet e ALPEX-it.
2. Vendimi Teknik Nr. 2-T i paraqitet për njoftim Entit Rregullator të Energjisë - ERE dhe Zyrës së Rregullatorit për Energji - ZRrE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI I ALPEX SH.A

Sokol Dishnica

Neni 1

Objekti - Fushëveprimi– Përkufizimet

- (a) Objektivi i këtij Vendimi Teknik është të përcaktojë kushtet e përshtatshmërisë së personave të emëruar dhe procedurën e certifikimit si Agjent Tregtar të Certifikuar, si dhe procedurën e aksesimit në Sistemin Elektronik të Tregtimit në Çast (ETSS), për tregtimin në tregjet e ALPEX-it, në përputhje me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.
- (b) Ky Vendim do të zbatohet për Anëtarët e Bursës dhe Agjentët Tregtar të Certifikuar.
- (c) Kur ky Vendim Teknik bën referenca tek shërbimi kompetent, do të thotë certifikimi/shërbimi i trajnimit i ofruar nga ALPEX.
- (d) Përkufizimet e këtij Vendimi Teknik kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Përkufizimet ose Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat dhe në legjislacionin përkatës lidhur me tregjet e energjisë elektrike.

Neni 2

Procesi i Certifikimit të personit të emëruar nga Anëtari i Bursës

2.1 Certifikata e Agjentit Tregtar (CAT)

- a) Me qëllim tregtimin në Tregjet e ALPEX, personit të emëruar nga Anëtari i Bursës duhet ti lëshohet një Certifikatë Tregtimi (në vijim referuar si "CAT").
- b) CAT lidhet me ushtrimin e detyrave të Agjentit Tregtar të Certifikuar në emër të Anëtarit të Bursës, në Tregjet e ALPEX-it.

2.2 Detyrimet e Anëtarit të Bursës

- a) Çdo person i emëruar i cili vepron si tregtar në emër të Anëtarit të Bursës duhet të ketë një CAT.
- b) Anëtari i Bursës duhet të sigurohet që Agjentët Tregtar të Certifikuar të tij, të zbatojnë me kompetencë në mënyrë të vazhdueshme Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat.

2.3 Aplikimi për marrjen e një CAT

Për të qenë i përshtatshëm për të aplikuar për një CAT, Aplikanti duhet të përmbushë në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

- i. Aplikanti duhet të ketë mbushur 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.
- ii. Aplikanti duhet të emërohet nga një Anëtar i Bursës, nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar ALPEX-it.
- iii. Nuk ka ndalesa për marrjen e CAT-it sipas parashikimeve të këtij Vendimi Teknik.
- iv. Aplikanti ka paguar tarifat përkatëse në favor të ALPEX-it në përputhje me Nenin 3, nën seksionin 3.5 të këtij Vendimi Teknik.
- v. Nuk është dënuar për këto vepra penale:
 - pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi;
 - korrupsion sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi;
 - mashtrim sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi;
 - pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi;
 - vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi;
 - falsifikim;
 - puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislationit në fuqi.
- vi. Aplikanti ka ndjekur rregullisht seancat e trajnimit dhe ka kaluar provimet për tu certifikuar si Tregtar, siç është specifikuar në Nenin 3, paragrafët 3.1 deri në 3.4.

2.3.1 Dokumentet mbështetëse të aplikimit.

- a) Aplikanti duhet të dorëzojë të plotësuar dhe të nënshkruar formularin standard, të dhënë në Aneksin A të këtij Vendimi Teknik.
- b) ID e Aplikantit.
- c) Një kërkesë të shkruar të lëshuar nga Anëtari i Bursës, i cili emëron Tregtarin/ët e tij.
- d) Dëshmi nga Gjykata dhe Prokuroria lidhur me gjendjen gjyqësore të aplikantit, lëshuar jo më vonë se 30 ditë. Për aplikantët e zonës ofertuese të Kosovës, kërkohet vetëm dëshmia nga Gjykata, sipas legjislationit në fuqi.
- e) Dëshmia e Penalitetit e lëshuar nga Autoritetet përkatëse për Aplikantin.
- f) Një Certifikatë të vlefshme nga Bursat e Energjisë së Shteteve Anëtare të BE-së, nëse është e aplikueshme.
- g) Aplikantët e huaj të cilët kanë një Certifikatë Tregtimi nga Bursat e Energjisë së Shteteve Anëtare të BE-së përjashtohen nga dorëzimi i dokumenteve të (d) dhe (e) më lartë. Këto aplikantë do të bëjnë një vetë deklaram lidhur me gjendjen gjyqësore

të tyre. Agjenti Tregtar i Certifikuar dhe/ose Anëtari i Bursës duhet të njoftojnë ALPEX-in për vlefshmërinë e statusit të certifikatës, në raste të ndryshimeve. Nëse Agjenti Tregtar i Certifikuar dhe/ose Anëtari i Bursës nuk e bëjnë një gjë të tillë, parashikimet e C.2 të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme do të aplikohen.

ALPEX-i do të vlerësojë dokumentacionin e sipërpërmendur dhe do t'i kërkojë aplikantit të paguajë Tarifën Vjetore të Trajnimit dhe Tarifën e Provimit, nëse janë përmbushur parashikimet e pikave 2.3, të cilat janë parakushte në mënyrë që Aplikanti të marrë pjesë në sesionet e trajnimit.

Nëse ALPEX-i nuk është i kënaqur me përmbushjen e kushteve të përshtatshmërisë, ALPEX-i do të japë një përgjigje të arsyetuar.

Neni 3

Termet dhe Kushtet e Seminareve dhe Provimeve për Lëshimin e CAT

3.1. Organi përgjegjës për seminarët dhe provimet CAT

- (a) Seminarët dhe provimet për lëshimin e një CAT do të kryhen nga ALPEX-i, nën mbikëqyrjen e Komisionit të Provimeve, sipas Nenit 3, nën seksionit 3.2.
- (b) Me qëllim kryerjen e seminareve të Certifikimit për dhënien e një CAT, Komisioni i Provimeve miraton paraprakisht programin e trajnimit, duke përfshirë materialin dhe provimin, në përputhje me Nenin 3, nën seksionin 3.3 si dhe lektorët e tyre.
- (c) ALPEX do të publikojë në faqen zyrtare të internetit, vendin dhe kohën e zhvillimit të seminareve të Certifikimit si dhe provimeve për lëshimin e një CAT, si dhe çdo çështje tjetër të lidhur me të.

3.2. Komisioni i Provimeve

- (a) Komisioni i Provimeve mbikëqyr provimet e Certifikimit në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë Vendim Teknik.
- (b) Komisioni i Provimeve do të jetë gjithashtu përgjegjës për kontrollin e kushteve për përjashtim nga provimet e Certifikimit në përputhje me Nenin 3, nën

seksioni 3.5 dhe për çdo çështje tjetër që lidhet me lëshimin e Certifikatës së Tregtimit.

(c) Anëtarët e Komisionit të Provimeve do të jenë pjesë e stafit të ALPEX.

3.3. Materiali i Studimit

- (a) Përmbajtja e materialeve të studimit do të jepet nga ALPEX-i.
- (b) Gjuha e materialit të studimit dhe ajo e provimit do të jetë në Shqip dhe/ose Anglisht, sipas kërkesës.

3.4. Provimi

- (a) Tarifa e Provimit duhet të paguhet përpara hyrjes në provim për Certifikim. Tarifa e provimit do të ri paguhet nëse Agjenti Tregtar i emëruar nuk kalon provimin. Nëse Agjenti Tregtar dëshiron të marrë pjesë përsëri në sesionet e trajnimit, duhet të paguajë Tarifën Vjetore të Trajnimit.
- (b) Komisioni i Provimeve do të vendosë, përpara kryerjes së provimeve, për çdo çështje që ka të bëjë me provimin.
- (c) Komisioni i Provimeve do të përgatisë pyetjet, do të mbikëqyrë procesin e provimit, Certifikimit dhe do të nënshkruajë provimin, si dhe do të përgatisë listën përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm. Kandidatët që i përgjigjen saktë gjashtëdhjetë për qind (60%) të pyetjeve, janë ata që konsiderohen të suksesshëm.
- (d) Provimi mund të kryhet fizikisht ose online, sipas rastit. Data dhe koha e provimit do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të ALPEX. Provimi online vlen vetëm për Tregtarët e huaj të emëruar.
- (e) Aplikanti duhet të dorëzojë formularin standard të plotësuar dhe të nënshkruar (TR-2-F1) për lëshimin e Certifikatës së Tregtimit, në mënyrë që të marrë Certifikatën e pjesëmarrjes në trajnim dhe Certifikatën e Tregtimit.

3.5. Tarifat në favor të ALPEX-it

Tarifat e Provimit janë publikuar sipas Listës së Tarifave të ALPEX-it në faqen zyrtare të internetit të ALPEX.

3.6. Pezullimi i një CAT

Një CAT që është dhënë në përputhje me kushtet e këtij Vendimi Teknik, pezullohet nga ALPEX-i:

- (a) Nëse vlefshmëria e Certifikatës sipas Nenit 2, nën seksioni 2.3.1, paragrafit (g) të këtij Vendimi Teknik, të paraqitur nga mbajtësi i CAT, është anuluar, revokuar, ose për ndonjë arsye është ndërprerë.

- (b) Nëse veprimet e Agjentit Tregtar të Certifikuar në Tregjet e ALPEX-it janë në shkelje të parashikimeve të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike – Kushtet e Përgjithshme dhe Procedurat, parashikimet përkatëse do ti aplikohen Anëtarit të Bursës.
- (c) Nëse informacioni dhe dokumentet mbështetëse të dorëzuara për lëshimin e një CAT-i provohet se janë të rreme ose manipuluese të së vërtetës.
- (d) Nëse Agjenti Tregtar i Certifikuar është dënuar sipas Nenit 2, nën seksionit 2.3 (v) të këtij Vendimi Teknik.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Vendim Teknik hyn në fuqi më datë 07.09.2023.

Ky Vendim Teknik do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të ALPEX www.alpex.al